VENDIM
Nr. 313, datë 9.5.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR MBROJTJEN E PUBLIKUT NGA SHKARKIMET NË MJEDIS, PËRCAKTIMIN E MOSTRAVE, RAJONEVE DHE FREKUENCËS SË MATJEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për mbrojtjen e publikut nga shkarkimet në mjedis, përcaktimin e mostrave, rajoneve dhe frekuencës së matjeve", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha